



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, _____.____.2020

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Për: **Shoqërinë “ECO RICIKLIM” Shpk**, NIPT: L61814009B

Adresa: Elbasan, Bradashesh, Pasuria Nr. 1070, Zona Kadstrale 3965, Metalurgji,
Bradashesh.

* * *

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur – Prokurim Elektronik – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-61075-06-11-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me COVID-19, marrëveshje kuadër me afat 12 muaj”

Fondi limit:

Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: **14’016’000** (katërbëdhjetë milion e gjashtëmbëdhjetë mijë) Lek pa TVSH dhe **16’819’200** (gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind) Lek me TVSH. **Çmimi për njësi 480.0** (katërqind e tetëdhjetë) **leke pa TVSH;**

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike [Dt. 15.06.2020] [Nr. 35]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë prokurimi, këto operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar / me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “ECO RICIKLIM” Shpk

L61814009B

Vlera ofertuar:

Me ofertën me vlerë/ me çmim për njësi: **336** (treqind e tridhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH**, si dhe me vlerë të pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: **9,811,200** (nente milion e teteqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind) **leke pa TVSH** dhe **11,773,440** (njëmbëdhjetë milion e shtateqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katerqind e dyzet) **leke me TVSH.**

2. “PURA-MEDICAL” Shpk

L71515507M

Vlera ofertuar:

Me ofertën me vlerë/ me çmim për njësi: **400** (katerqind) **lekë pa TVSH**, si dhe me vlerë të pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: **11,680,000** (njembedhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) **leke pa TVSH** dhe **14,016,000** (katëmbëdhjetë milion e gjashtëmbëdhjetë mijë) **leke me TVSH**.

3. “MEDI - TEL” Shpk

J71519004W

Vlera ofertuar:

Me ofertën me vlerë/ me çmim për njësi: **460** (katerqind e gjashtëdhjetë) **lekë pa TVSH**, si dhe me vlerë të pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: **13,432,000** (trembedhjetë milion e katerqind e tridhjetë e dy mijë) **leke pa TVSH** dhe **16,118,400** (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katerqind) **leke me TVSH**.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. “PURA-MEDICAL” Shpk

L71515507M

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko ligjor të administruar nga OE “PURA-MEDICAL” Shpk në sistemin e prokurimi elektronik (SPE), rezulton se:

1. Ne DST e publikuara ne SPE per kete procedure prokurimi ne Kriteret e vecanta te kualifikimit: **3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë është kerkuar:**

c) Operatori duhet të ketë certifikatën **ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

ç) Operatori, duhet të ketë certifikatën **ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambjentit”** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

➤ *Ne zbatim të rekomandimit të APP dhe DPA date 20.03.2018 të gjitha certifikatat e cilësisë duhet të jenë të vlefshme dhe të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilësisë janë të akredituar nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga republika e Shqipërisë.*

OE Pura Medical ka paraqitur certifikate ISO 9001:2015 me Nr.568 Q e leshuar me date 23.01.2019 dhe certifikate ISO 14001:2015 me Nr. 568 E date 23.01.2019

Nga certifikatat e paraqitura vihet re se keto certifikata janë leshuar me date 23.01.2019 dhe janë konfirmuar për herë të fundit me date 23.01.2019

OE nuk ka paraqitura ndonjë konfirmim të auditit vjetor, i cili është i detyrueshëm të bëhet çdo 1 (një) vit pas leshimit, që të konfirmojë vlefshmerinë vijuese të këtyre certifikatave. Pra, keto certifikata nuk rezultojnë të jenë të konfirmuara për vlefshmeri nga data 23.01.2019.

2. Ne DST e publikuara ne SPE per kete procedure prokurimi ne Kriteret e vecanta te kualifikimit: **3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar**, është kerkuar: a) Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (**2016, 2017, 2018**) të operatorit ekonomik pjesëmarrës, të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet.

- Nga verifikimi I dokumentacionit të paraqitur nga OE Pura Medical per kete procedure prokurimi, rezulton se nuk ka paraqitur bilancet per vitin 2016.

3. Ne DST e publikuara ne SPE per kete procedure prokurimi ne Kriteret e vecanta te kualifikimit: **3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar**, eshte kerkuar: b) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit (2016, 2017 dhe 2018) ku vlera mesatare e tyre te jete 40 % e vlerës e fondit limit të kontrates qe prokurohet

- Nga verifikimi I dokumentacionit të paraqitur nga OE Pura Medical per kete procedure prokurimi, rezulton se nuk ka paraqitur Xhiro vjetore per vitin 2016.

4. Ne DST e publikuara ne SPE per kete procedure prokurimi ne Kriteret e vecanta te kualifikimit: 3.3 Kapaciteti teknik, eshte kerkuar:

ç) OE për të vërtetuar funksionalitetin e Autoklavës/Hidroklavës dhe Inceneratorit, duhet të paraqesë Autodeklaratë ku të deklarojë se Autoklava/Hidroklava dhe Inceneratori janë të pajisura me printer i cili regjistron dhe printon çdo detaj të procesit të punës (*Ndezja, Hapja e Pajisjes, Fillimi i Procesit të Punës, Temperaturën, Presionin etj.,*). Autodeklarata duhet të shoqërohet me disa printime (2 ose 3 printime) të autoklavës/hidroklavës dhe inceneratorit, gjatë 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës.

- OE Pura Medical ka paraqitur nje vetedeklarate e cila mban daten 18.08.2020 ne te cilen deklarone se Impiantet e tij jane te lidhur me printera te cilet printojne rregjistrojne dhe printojne cdo detaj te procesit te punes si *Ndezja, Hapja e Pajisjes, Fillimi i Procesit të Punës, Temperaturën, Presionin etj.,*

Ne printimet qe ky OE ka paraqitur ne DST verehet se ka paraqitur vetem nje printim i cili nuk eshte qartesisht i dukshem dhe nuk kuptohet absolutisht nese eshte i hidroklaves/autoklaves apo i Inceneratorit. Eshte paraqitur vetem nje printim vetem per nje impiant kur ne DST jane kerkuar 2-3 printime per cdo muaj per 3 (tre) muajt e fundit, kurse per impiantin tjeter nuk eshte paraqitur asnje printim. Per me teper printimi eshte fotokopje dhe nuk eshte as origjinale (me vule te njome nga perfaqesuesit e shoqerise) dhe as i noterizuara.

5. Ne DST e publikuara ne SPE per kete procedure prokurimi ne Kriteret e vecanta te kualifikimit: 3.3 Kapaciteti teknik, eshte kerkuar:

e) Të vërtetojë nëpërmjet dokumentacionit se pas trajtimit të mbetjeve spitalore (*sterilizimit me autoklavë/hidroklave*) dhe asgjësimit me incenerator, operatori i dorëzon mbetjet e trajtuara në landfill të licënsuar apo i eksporton jashtë Republikës së Shqipërisë, për këtë qëllim duhet të dorëzoje:

- *Kontratë të vlefshme me Landfill të licensuar per depozitimin e mbetjeve spitalore pas trajtimit.*
- *Kontratë të vlefshme me Landfill të licensuar per depozitimin e hirit qe del nga asgjesimi i mbetjeve spitalore me incenerim.*
- *Kopje te licences se landfillit (për mbetjet e trajtuara me autoklave dhe per hirin) ku te cilësohet se eshte i licensuar per grumbullimin e ketyre lloj mbetjesh.*
- *Në rastin e eksportit, Kontratë me subjekt të licënsuar për eksportin jashtë RSH ose Autorizim për Eksport të Mbetjeve / Produkteve (hirit) që dalin nga Trajtimi dhe Asgjësimi i Mbetjeve.*

- OE Pura Medical ka paraqitur disa akt-marreveshje me "AlbtekEnergy" shpk, ku akt-marreveshje me date 05.04.2017 midis "AlbtekEnergy" shpk dhe "Jamarber Group" shpk eshte vetem per mbetjet spitalore pas trajtimit dhe jo per hirin.

Po ashtu akt-marreveshja midis "AlbtekEnergy" dhe "Pura Medical" shpk e lidhur me date 16.07.2020 ka afat 1 (nje) mujor me te drejte ripërteritje, por nga OE nuk eshte paraqitur asnje dokument qe verteton per rinovimin e saj.

- OE Pura Medical ka paraqitur gjithashtu nje akt-marreveshja midis "AlbtekEnergy " dhe "Pura Medical" shpk e lidhur me date 16/08/2020. Landfilli i Qarkut te Elbasanit i cili administrohet nga "AlbtekEnergy "shpk nuk eshte i licencuar te grumbulloje mbetje hiri nga pale te treta, por vetem per depozitimin e hirit qe gjeneron nga inceneratori i tij. Vlen per tu permendur se ne Republiken e Shqiperise nuk ka asnje venddepozitim te licencuar per depozitimin e Hirit. Gjithashtu, referuar dhe komunikimit nga ana jone me Agjensine Kombetare te Mjedisit (AKM) si autoritet kompetet ku i kerkuam te na sqaronin nese subjekti "ALBTEK ENERGY" shpk me NIPT: L41914013H eshte i licencuar te grumbulloje nga pale te treta hirin qe del si rezultat i asgjesimit me incenerim te mbetjeve te rrezikshme spitalore infektive? AKM me ane te pergjigjes se saj na informon se operator "Albtek Energy" disponon leje mjedisore per "Landfillimin e mbetjeve qe gjenerohen nga proceset e incenerimit te mbetjeve urbane...".

Per sa me siper argumentuam, OE Pura Medical nuk përmbush kriteret e përcaktuara në DST nga AK, sipas përcaktimeve të nenit 53, pika 3, 5/c, dhe nenit 54 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, si dhe Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. "ECO RICIKLIM" Shpk

L61814009B

Vlera ofertuar:

Me ofertën me vlerë/ me çmim për njësi: **336** (treqind e tridhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH**, si dhe me vlerë të pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: **9,811,200** (nente milion e teteqind e njembedhjetë mijë e dyqind) **leke pa TVSH** dhe **11,773,440** (njembedhjetë milion e shtateqind e shtatedhjetë e tre mijë e katerqind e dyzet) **leke me TVSH**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, me adresë: Rruga e Dibrës, Nr. 372 – Tiranë, Tel/Fax: + 355 42 362627 / 363644, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes / publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë:

- Klasifikimi i parë i ofertave është bërë në datën 04.09.2020
- Riklasifikimi i ofertave është bërë ne datën 16.11.2020

Ankesa:

Ka patur ankesë nga OE pjesemarres "Pura Medical" Shpk, protokolluar ne QSUNT me nr. 2806 prot., datë 10.09.2020, pas shqyrtimit nga ana e komisionit te shqyrtimit te ankeses i eshte kthyer pergjigje OE me shkresen nr. 2806/5 prot, date 24.09.2020, si dhe ankesë nga OE pjesemarres "Eco Riciklim" Shpk, protokolluar ne QSUNT me nr. 2819 prot., datë 24.09.2020, pas shqyrtimit

nga ana e komisionit te shqyrtimit te ankeses i eshte kthyer pergjigje OE me shkresen nr. 2819/3 prot, date 24.09.2020.

Kunder vendimarrjes se AK per mospranimin e ankeses se tij, OE “Eco Riciklim” Shpk i eshte drejtuar Komisionit te Prokurimit Publik, ku ky i fundit me vendimin nr. 499/2020 prot, date 04.11.2020, administruar ne QSUNT me nr. 2086/10, date 10.11.2020, i cili ka vendosur te pranoje ankesen e paraqitur nga OE “Eco Riciklim” Shpk per kete procedure prokurimi. Ne zbatim te vendimit nr. 499/2020 prot, date 04.11.2020 te KPP-se, AK (komisioni i vleresimit të ofertave) me date 16.11.2020 bëri rivleresimin e ofertave, pas rivleresimit te ofertave me shkresen tone nr. 2086/16 prot, date 20.11.2020 drejtuar Komisionit te Prokurimit Publik kemi vene ne dije KPP per zbatimin e vendimit nr. 499/2020 prot, date 04.11.2020 për procedurën e prokurimit me objekt: **“Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me COVID-19, marrëveshje kuadër me afat 12 muaj”**. Procedura u hoq nga pezullimi me vendimin nr. 499/4/2020 te KPP, protokulluar ne QSU “Nene Tereza” me nr. 2086/17, date 25.11.2020. Pas rivleresimit te ofertave ne zbatim te vendimit nr. 499/2020 prot, date 04.11.2020 te KPP-se, nuk ka patur ankesa.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Enkelejdi JOTI